

URDHËR
Nr. 89, datë 15.3.2022

**PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË INSPEKTORËVE
FINANCIARË PUBLIKË, EKSPERTË TË JASHTËM, PUNONJËS TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE APO JASHTË SAJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 112/2015, “Për inspektimin financiar publik”, dhe të pikës 9, të vendimit nr. 84, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

URDHËRON:

1. Shpalljen e procesit të përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj në profesionet: informatikë, teknologji informacioni, si dhe inxhinieri (ndërtimi/mjedisi/hidro/miniera etj.).

2. Aplikanti për inspektor financiar publik, ekspert i jashtëm, punonjës i administratës publike apo jashtë saj duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në vendimin nr. 84, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”.

3. Afati i aplikimit të kandidatëve për t’u përzgjedhur në listën e inspektorëve financiarë publikë është 40 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Aplikanti do të dorëzojë në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet rrugës postare apo dorazi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) fotokopje të kartës së identitetit;
- c) adresën e vendbanimit, vendit të punës dhe pikave të kontaktit;
- ç) kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;
- d) një fotografi të përmasave 4 x 6;
- dh) kopje të licencave dhe/ose të certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj;
- e) dëshmi dhe certifikata të trajnimeve dhe të kualifikimeve pasuniversitare;
- ë) vërtetim nga qendra e punës për funksionin që kryen dhe lejimin në rast angazhimi, kur aplikanti është punonjës i administratës publike;
- f) numrin unik të identifikimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të ekstraktit historik, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;
- g) një dokument që vërteton se aplikanti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;
- gj) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shpërndahet nëpërmjet rrugëve elektronike zyrtare dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj